



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2200/4 prot

Datë 03.08.2026

V E N D I M
Nr.932/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.08.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albanian Furniture Office” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-91948-07-01-2026, me objekt “Loti II: Arredim i kopshtit dhe i cerdhes”, me fond limit 6,366,213.50 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 17.07.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec

Ankimues: Operatori ekonomik “Albanian Furniture Office” SHPK me NIPT M32303056L dhe adresë: *Tirane Vore Autostrada Tiranë–Durrës, Picar, Njësia Administrative Vorë*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Pogradec me adresë: Lagjia nr 2, Bulevardi "Reshit Çollaku", Pogradec

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.07.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-91948-07-01-2026, me objekt “Loti II: Arredim i kopshtit dhe i cerdhes”, me fond limit 6,366,213.50 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 17.07.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

II.2. Në datën 08.07.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6931 dhe me nr. 2200/2026 prot., datë 08.07.2026, e operatorit ekonomik “Albanian Furniture Office” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 2617/9 prot., datë 13.07.2026 me lëndë: “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 2200/1 prot., datë 13.07.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në të cilën është vendosur pranimi i ankesës si më poshtë vijon:

“Me mberritjen e ankesës, titullari i autoritetit kontraktor ka urdhëruar ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesës (KSHA), e cila pasi ka marrë në shqyrtim ankesën shprehet si më poshtë:

Kemi konkluduar:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me Modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit. Operatori ekonomik “Albanian Furniture Office” shpk ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Ankimuesi gjithashtu ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në ankesë ngrihen pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të tendërit, si më poshtë vijon:

1- Lidhur me Pikën 2.3.8 të kriterëve të vecanta për kualifikim të DST (paraqitja e mostrave) sipas oe ankimues është një kriter kufizues dhe jo proporcional, prandaj kërkon heqjen e këtij kriteri, si kriter në kundërshtim me ligjin .

KSHA-ja vëren se nga AK është kërkuar që operatorët pjesëmarrës sipas pikës 2.3.8 të kriterëve të vecanta për kualifikim të DST të plotësojnë kriterin si më poshtë cituar:

2.3.8 Operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambjentet e magazinës të Bashkisë Pogradec në datën 17/07/2026 deri në orën 10:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse), mostrat për zërat si më poshtë:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
2	Tavoline me ngjyra - Tavoline per femije, 79x79x50 cm, polipropilen	Cope	1
15	Karrige femijesh - Materialet: skelet me konstruksion dru ahu i staxhionuar, i lyer me ngjyra të ndryshme. Ulësja me pllakë zdrukthi e veshur me sfungjer dhe tapiceri me ngjyra të ndryshme, mbështetësja e karriges e formësuar multistrate (kompesatë shumështrësore). Dim. 55 x 29 x 32 cm. Të plotësojë kërkesat e standartit EN 1728:2012, EN 1022:2023	Cope	1
20	Krevate femijesh - Krevati prodhohet me MDF me lyerje me trashësi 1.8 cm. Të gjitha anët janë të rumbullakosura për të shmangur dëmtimet e mundshme. Në pjesën e brendshme ndodhet një gradelë prej druri për mbajtjen e dyshekut. Krevati vendoset mbi rrota të lëvizshme. Dim. 125 x 66 x 72 Cm Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1725:2023	Cope	1
28	Tavoline zyre - Suprina është me material pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm, me veshje laminati me		1

30	rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të veshura me material PVC me trashësi 1mm. Këmbët dhe lidhëset e tyre të jenë të ndërtuara nga material metalik me seksion 30 x 30 mm, të cilët bashkohen me tyre me anë të saldimit me hark elektrik. Këto duhet të jenë të lyera me bojë me fushë elektrostatiqe për ti rezistuar korrozionit. Bashkimi i planit të punës (suprinës) do të realizohet në mënyrë që t'i japë tavolinës një pamje estetike dhe solide. Këmbët janë të pajisura me mekanizëm nivelues dhe me rrota, në mënyrë që të jetë e lehtë lëvizja e tavolinës. Tavolina është në formë drejtëkëndore. Kjo lejon që disa tavolina të lidhen së bashku duke formuar një strukturë të hapur, e cila mund të përshtatet në forma të ndryshme, varësisht nga nevojat e hapësirës së punës. Tavolina duhet të ketë hapësirë për menaxhimin e kablllove, duke lejuar kalimin e tyre nëpër kanale të dedikuara ose përmes elementëve të konstruksionit së tavolinës. Dim. 150x68x75cm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-1:2015/AC:2016, SSH EN 1729-2:2023 Karrige per mbledhje - Karrige me strukturë metalike, me seksion tërthor tip tub oval 30x15 mm, me spesor $\delta = 1.5$ mm dhe lidhëza metalike tubolare me diametër $\varnothing = 18$mm dhe trashësi $\delta = 1.35$mm që bashkojnë këmbët, të cilat janë kurbuar. Ndërsa struktura e shpinës është kurbuar me kënd jo më i madh se 105°, në mënyrë që të formojë një qëndrim ergonomik ulëses dhe mbështetëses. Struktura metalike lyhet me bojë elektrostatiqe në temperaturën 200°, me ngjyrë të zezë. Fundi i këmbëve dhe anësoret e tyre mbulohen me tapa plastike. Ndenjësja dhe shpina janë me strukturë të qëndrueshme, të mbushur me sfungjer me densitet të lartë me trashësi 35 mm. Në pjesën e brendshme të veshura me tekstil ose lëkurë ekologjike, ndërsa në pjesën e jashtme mbulohen me kapak plastik të së njëjtës formë. Përmasa përfundimtare e ndenjësës 47 x 44 cm, më lartësi nga dysheja 45-50 cm, ndërsa shpinorja 47 x 35 cm, me lartësi nga dysheja 80 cm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 Karrige per mesues - Karrigia duhet të jetë me strukturë metalike, bazament mbështetës nëformë U, me përmasa ndenjësja 46 cm x 47 cm, shpinorja të jetë nëformë të harkuar me përmasa 60 cm x 48 cm. Gjatësia e shpinores duhet të zbrësë poshtë nivelit të ndenjësës. Përmasat e bazamentit mbështetës 57 cm x 47 cm. Lartësia totale të jetë 94 cm. Shpinorja dhe ndenjësja duhet të jenë të veshura me lëkurë ekologjike. Të	1
32		1

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave dhe përshtatshmërinë që duhet të kenë në objektet ekzistuese ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

Shënim: Mosparaqitja e mostrave në ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike sipas DST, përben kusht skualifikues. Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre. Mostrat e dorëzuara do të kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Në lidhje me pretendimin tuaj KSHA, gjykon se: Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit. AK në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, mban në konsideratë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, KSHA gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KSHA konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës dhe konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm

kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisht të specifikimeve teknike të produktit. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve të parashtruara nga operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij, gjykojmë, se referuar objektit të prokurimit si dhe natyrës së produkteve që kërkohet të furnizohet, kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostres për artikujt e sipërpërmendur nuk është një kërkesë e ekzagjeruar dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit që kërkohet të prokurohet. Pasi vlen të theksojmë se qëllimi i autoritetit kontraktor, është furnizimi në kohë dhe në cilësi me produktet objekt-prokurimi, por në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, kriteret e kualifikimit të hartuara nga autoriteti kontraktor, nuk diskriminon/përjashton nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit.

Thelbi është se Mostrat në vetvete shërbejnë për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor me specifikimet teknike të vetë produktit, informacion ky të cilin në objektin konkret të prokurimit, autoriteti kontraktor mund ta arrijë edhe përmes paraqitjes së katalogëve ose skedës teknike, kërkesa të cilat autoriteti kontraktor i ka parashikuar në dokumentet e tenderit si një garanci për përmbushjen me sukses dhe cilësi të furnizimit të mallit të kërkuar, prandaj KSHA konsideron se kërkesa për paraqitjen e mostrës për verifikimin e përputhshmërisë së specifikave të saj me specifikimet teknike në dokumentet e tenderit është një kërkesë që mund të evitohet duke qenë se AK mund të krijojë besueshmëri dhe garanci nepermjet kriterëve të tjera të vendosura në DT dhe rrjedhimisht pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit OE) “Albanian Furniture Office” shpik qëndron.

Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të ankimit, KSHA i ngritur për shqyrtimin e saj,

VENDOSI :

- 1- **Të pranojë ankesën e OE “Albanian Furniture Office” shpk**, duke e konsideruar atë (ankesën) të mbështetur në ligj dhe në rregullat e prokurimit publik.
- 2- **Autoriteti Kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse** në përputhje me arsyetimet dhe kostatimet e KSHA-së, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve (SPE), menjëherë pasi procedura e prokurimit të hiqet nga pezullimi..
- 3- **Të njoftohet për shqyrtimin e kësaj ankesë i interesuari dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP).**

Të nderuar!

Vazhdoni të jeni të interesuar në çdo procedurë të prokurimit që ne do të zhvillojmë, për të cilat ju garantoj se do të keni vlerësim korrekt dhe vetëm sipas ligjit .

II.5. Nga verifikimet në SPE rezulton se autoriteti kontraktor bazuar në vendimmarrjen e KSHA e cila ka vendosur pranimin e ankesës nuk ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Me shkresën nr. 2617/9 prot., datë 13.07.2026 me lëndë: “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 2200/1 prot., datë 13.07.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në të cilën është vendosur pranimi i ankesës si më poshtë vijon:

“Me mberritjen e ankesës, titullari i autoritetit kontraktor ka urdhëruar ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesës (KSHA), e cila pasi ka marrë në shqyrtim ankesën shprehet si më poshtë:

Kemi konkluduar:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me Modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit. Operatori ekonomik “Albanian Furniture Office” shpk ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Ankimuesi gjithashtu ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në ankesë ngrihen pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, si më poshtë vijon:

1- Lidhur me Pikën 2.3.8 të kriterëve të vecanta për kualifikim të DST (paraqitja e mostrave) sipas oe ankimues është një kriter kufizues dhe jo proporcional, prandaj kërkon heqjen e këtij kriteri, si kriter në kundërshtim me ligjin .

KSHA-ja vëren se nga AK është kërkuar që operatorët pjesëmarrës sipas pikës 2.3.8 të kriterëve të vecanta për kualifikim të DST të plotësojnë kriterin si më poshtë cituar:

2.3.8 Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambientet e magazinës të Bashkisë Pogradec në datën 17/07/2026 deri në orën 10:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse), mostrat për zërat si më poshtë:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
2	Tavoline me ngjyra - Tavoline për femije, 79x79x50 cm, polipropilen	Cope	1
15	Karrige femijesh - Materialet: skelet me konstruksion dru ahu i staxhionuar, i lyster me ngjyra të ndryshme. Ulësja me pllakë zdrukthi e veshur me sfungjer dhe tapiceri me ngjyra të ndryshme, mbështetësja e karriges e formësuar multistratë (kompesatë shumështrësore). Dim. 55 x 29 x 32 cm. Të plotësojë kërkesat e standartit EN 1728:2012, EN 1022:2023	Cope	1
20	Krevate femijesh - Krevati prodhohet me MDF me lysterje me trashësi 1.8 cm. Të gjitha anët janë të rrumbullakosura për të shmangur dëmtimet e mundshme. Në pjesën e brendshme ndodhet një gradelë prej druri për mbajtjen e dyshekut. Krevati vendoset mbi rrota të lëvizshme. Dim. 125 x 66 x 72 Cm Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1725:2023	Cope	1
28	Tavoline zyre - Suprina është me material pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm, me veshje laminati me		1

	rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të veshura me material PVC me trashësi 1mm. Këmbët dhe lidhëset e tyre të jenë të ndërtuara nga material metalik me seksion 30 x 30 mm, të cilët bashkohen me tyre me anë të saldimit me hark elektrik. Këto duhet të jenë të lyera me bojë me fushë elektrostatische për ti rezistuar korrozionit. Bashkimi i planit të punës (suprinës) do të realizohet në mënyrë që t'i japë tavolinës një pamje estetike dhe solide. Këmbët janë të pajisura me mekanizëm nivelues dhe me rrota, në mënyrë që të jetë e lehtë lëvizja e tavolinës. Tavolina është në formë drejtëkëndore. Kjo lejon që disa tavolina të lidhen së bashku duke formuar një strukturë të hapur, e cila mund të përshtatet në forma të ndryshme, varësisht nga nevojat e hapësirës së punës. Tavolina duhet të ketë hapësirë për menaxhimin e kabllave, duke lejuar kalimin e tyre nëpër kanale të dedikuara ose përmes elementëve të konstruksionit të tavolinës. Dim. 150x68x75cm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015; SSH EN 1729-1:2015/AC:2016, SSH EN 1729-2:2023 Karrige për mbledhje - Karrige me strukturë metalike, me seksion tërthor tip tub oval 30x15 mm, me spesor $\delta = 1.5$ mm dhe lidhëza metalike tubolare me diametër $\varnothing = 18$ mm dhe trashësi $\delta = 1.35$ mm që bashkojnë këmbët, të cilat janë kurbuar. Ndërsa struktura e shpinës është kurbuar me kënd jo më i madh se 105°, në mënyrë që të formojë një qëndrim ergonomik ulëses dhe mbështetëses. Struktura metalike lyhet me bojë elektrostatische në temperaturën 200°, me ngjyrë të zezë. Fundi i këmbëve dhe anësoret e tyre mbulohen me tapa plastike. Ndenjësja dhe shpina janë me strukturë të qëndrueshme, të mbushur me sfungjer me densitet të lartë me trashësi 35 mm. Në pjesën e brendshme të veshura me tekstil ose lëkurë ekologjike, ndërsa në pjesën e jashtme mbulohen me kapak plastik të së njëjtës formë. Përmasa përfundimtare e ndenjësës 47 x 44 cm, më lartësi nga dyshemeja 45-50 cm, ndërsa shpinorja 47 x 35 cm, me lartësi nga dyshemeja 80 cm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 Karrige për mesues - Karrigia duhet të jetë me strukturë metalike, bazament mbështetës nëformë U, me përmasa ndenjësja 46 cm x 47 cm, shpinorja të jetë nëformë të harkuar me përmasa 60 cm x 48 cm. Gjatësia e shpinores duhet të zbrësë poshtë nivelit të ndenjësës. Përmasat e bazamentit mbështetës 57 cm x 47 cm. Lartësia totale të jetë 94 cm. Shpinorja dhe ndenjësja duhet të jenë të veshura me lëkurë ekologjike. Të		
30			1
32			1

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave dhe përshtatshmërinë që duhet të kenë në objektet ekzistuese ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

Shënim: *Mosparaqitja e mostrave në ditën e hapjes së ofertave dhe ne rast se mostrat nuk janë ne përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike sipas DST, perben kusht skualifikues. Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre. Mostrat e dorëzuara do të kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

Në lidhje me pretendimin tuaj KSHA, gjykon se: *Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit. AK në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, mban në konsideratë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.*

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, KSHA gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KSHA konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës dhe konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm

kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisht të specifikimeve teknike të produktit. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve të parashtruara nga operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij, gjykojmë, se referuar objektit të prokurimit si dhe natyrës së produkteve që kërkohet të furnizohet, kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostres për artikujt e sipërpërmendur nuk është një kërkesë e ekzagjeruar dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit që kërkohet të prokurohet. Pasi vlen të theksojmë se qëllimi i autoritetit kontraktor, është furnizimi në kohë dhe në cilësi me produktet objekt-prokurimi, por në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, kriteret e kualifikimit të hartuara nga autoriteti kontraktor, nuk diskriminon/përjashton nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit.

Thelbi është se Mostrat në vetvete shërbejnë për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor me specifikimet teknike të vetë produktit, informacion ky të cilin në objektin konkret të prokurimit, autoriteti kontraktor mund ta arrijë edhe përmes paraqitjes së katalogëve ose skedës teknike, kërkesa të cilat autoriteti kontraktor i ka parashikuar në dokumentet e tenderit si një garanci për përmbushjen me sukses dhe cilësi të furnizimit të mallit të kërkuar, prandaj KSHA konsideron se kërkesa për paraqitjen e mostrës për verifikimin e përputhshmërisë së specifikave të saj me specifikimet teknike në dokumentet e tenderit është një kërkesë që mund të evitohet duke qenë se AK mund të krijojë besueshmeri dhe garanci nepermjet kriterëve të tjera të vendosura në DT dhe rrjedhimisht pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit OE) “Albanian Furniture Office” shpik qëndron.

Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të ankimit, KSHA i ngritur për shqyrtimin e saj,

VENDOSI :

- 1- **Të pranojë ankesën e OE “Albanian Furniture Office” shpk**, duke e konsideruar atë (ankesën) të mbështetur në ligj dhe në rregullat e prokurimit publik.
- 2- **Autoriteti Kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse** në përputhje me arsyetimet dhe kostatimet e KSHA-së, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve (SPE), menjëherë pasi procedura e prokurimit të hiqet nga pezullimi..
- 3- **Të njoftohet për shqyrtimin e kësaj ankesë i interesuari dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP).**

Të nderuar!

Vazhdoni të jeni të interesuar në çdo procedurë të prokurimit që ne do të zhvillojmë, për të cilat ju garantoj se do të keni vlerësim korrekt dhe vetëm sipas ligjit .

III.1.1. Nga verifikimet në SPE rezulton se autoriteti kontraktor bazuar në vendimmarrjen e KSHA e cila ka vendosur pranimin e ankesës nuk ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit.

III.1.2. Neni 30, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se : *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

III.1.4. Duke qenë, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimes rezultojnë të jenë pranuar nga autoriteti kontraktor, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar

Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi por autoriteti kontraktor duhet të publikojë shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin e KSHA të dërguar në KPP përmes shkresës me nr. 2617/9 prot., datë 13.07.2026 protokolluar me tonën me nr. 2200/1 prot., datë 13.07.2026.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albanian Furniture Office” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-91948-07-01-2026, me objekt “Loti II: Arredim i kopshtit dhe i cerdhes”, me fond limit 6,366,213.50 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 17.07.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.
 2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën për ndryshimin e dokumentave të tenderit në përputhje me vendimin e KSHA të dërguar në KPP përmes shkresës me nr. 2617/9 prot., datë 13.07.2026 protokolluar me tonën me nr. 2200/1 prot., datë 13.07.2026.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albanian Furniture Office” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu